




		REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLICA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr. Prot.	01-575/15
Dep.		Bi. Prot.	
Dep.		Prot. No.	
Nr. fletë	02	Data	27-02-2015
Broj stranica		Datum	
Nr. pages		Date	
PRISHTINE			



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI – CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korruptionit si dhe nenin 24 paragrafi 11 dhe 12 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korruptionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korruptionit me datë 25.02.2015, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbylljet rasti me Nr. AKK-03-3541-14 për z.Xhihad Vuçitërna-Këshilltar Komunal në Komunën e Rahovecit, për shkak se është shmangur situata e konflikti të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt interesit në ushtrimin e funksionit publik, me nr. AKK-03-3541-14, për Zyrtarin e lartë, z.Xhihad Vuçitërna – Këshilltar në Asamblenë Komunale Rahovec, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Zyrtari i lartë, z. Vuçitërna fillimisht është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korruptionit (AKK-Z.D/DPK-01-3630/14), pas të cilës ai është kontaktuar nga zyrtarët e Agjencisë kundër Korruptionit, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë, për të shmangur dhe për të parandaluar kështu situatën e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit të tij publik.

Zyrtari i lartë, z.Xhihad Vuçitërna, është deklaruar se dy nga bizneset e tija mund të bëjë ndryshimet e kërkua, ndërsa për biznesin e tretë në të cilin po ashtu është i caktuar si person i autorizuar ka deklaruar se nuk funksionon, është pasiv, dhe se ai vetëm ka mbet i regjistruar nga disa ndërmarrës te huaj të cilët tashmë e ka vështirë edhe t'i kontaktoi në mënyrë që të bëjë çregjistrimin (shuarjen) apo edhe ndryshimet eventuale në te.

Ndërkohë, z. Vuçitërna, në Agjencinë kundër Korruptionit, ka sjellë shkresën zyrtare nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (ARBK) "Informata mbi biznesin" (DPK/DPKI-03-4272/14) në të cilën shihet se z. Vuçitërna tash nuk e ushtron funksionin e

personit të autorizuar të biznesi “Code-X Technology” sh.p.k. sepse në këtë pozitë e ka zgjedhur një person të besuar.

Po ashtu me datën 01.12.2014 z. Vuçitërna në AKK ka sjellë edhe shkresën e dytë “Informata mbi biznesin” (DPK/DPKI-03-4495/14) në të cilën shihet se z. Vuçitërna tash nuk e ushtron funksionin e personit të autorizuar as të biznesi N.Sh. “Code-X” sepse edhe në këtë pozitë e ka zgjedhur një person të besuar, ashtu siç e kërkon ligji për Parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrتari i lartë publik
- Drejtorit të DPK-së
- Z./zpj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./zpj. (zyrtari ndihmës)

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit

/ Hasan Preteni/ 

